



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTËSISË

REPUBLIKË E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT
PUBLIK

Nr. 52 Prot.
Datë 14.01.2025

Nr. 380 Prot.
Datë 14.01.2025

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI
MIDIS
FAKULTETIT TË DREJTËSISË TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS
DHE
AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK**

Fakulteti i Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, (FD), që ushtron veprimtarinë në përputhje me ligjin nr.80/2015 “*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*”, si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi, i përfaqësuar nga **Dekani, Prof. Dr. Dorina Hoxha**, Agjencia e Prokurimit Publik (APP), person juridik publik, që ushtron veprimtarinë në bazë të ligjit nr. 162/2020, “*Për Prokurimin Publik*”, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi, përfaqësuar nga **Znj. Reida Kashta (Shahollari)**, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Prokurimit Publik,

FD dhe APP (këtu e në vijim të quajtura “Palët”), bien dakord për sa vijon:

**NENI 1
QËLLIMI I MEMORANDUMIT**

Ky memorandum bashkëpunimi ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit midis Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës dhe Agjencisë së Prokurimit Publik në fusha me interes të përbashkët.

NENI 2 OBJEKTIVAT

Palët angazhohen për të bashkëpunuar ngushtësisht për çështjet me interes të përbashkët, me qëllim arritjen e këtyre objektivave:

- a) Identifikimin e mekanizmave të nxitjes së punës kërkimore shkencore të universitetit dhe zbatimit praktik të tyre në punën e APP dhe ofrimin nga ana e APP të mbështetjes për punën kërkimore shkencore në tema të lidhura në fusha me interes të përbashkët;
- b) Përfshirjen e temave që lidhen me procesin administrativ të prokurimit publik për studentët, si pjesë e moduleve mësimore të Fakultetit të Drejtësisë;
- c) Organizimin e konferencave të përbashkëta, trajnimeve, intershiipeve, leksioneve të hapura, seminareve, praktikave mësimore apo takimeve;
- d) APP angazhohet në ofrimin e mundësive për zhvillimin e praktikave të punës ose kontratave të punës sipas programeve të Qeverisë.
- e) Fakulteti Juridik angazhohet në vënien në dispozicion, rast pas rasti, nëse do të jetë e nevojshme, të sallave për zhvillimin e testimeve në kuadër të certifikimit të detyrueshëm të specialistëve të prokurimit në zbatim të programit të profesionalizimit.
- f) Shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit në lidhje me funksionin dhe kontributin e FD nëpërmjet studimeve të fushave të ndryshme të lidhura me aktivitetin e FD dhe APP;
- g) Nxitjen dhe motivimin për punime shkencore të studentëve dhe kandidatëve për marrjen e titujeve akademikë që krijojnë/kryejnë punime shkencore, kërkimore, akademike e universitare në ndihmesë të institucioneve publike.

NENI 3 MËNYRAT E BASHKËPUNIMIT

1. Me qëllim përbushjen e objektivave të këtij memorandumi, secila palë do të caktojë një person si bashkëkoordinues për komunikimin midis tyre dhe përcjelljen e problematikave sipas rastit.
2. Palët angazhohen për gadishmërinë dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm për çështje me interes të përbashkët.

3. Palët bien dakord se do të organizohen për të vënë në dispozicion të publikut të gjerë, informacionin dhe rezultatet e çdo veprimi të përbashkët, përmes medias së shkruar dhe asaj vizive.


NENI 4 **KOHËZGJATJA E MEMORANDUMIT**

1. Ky memorandum bashkëpunimi lidhet për një afat kohor të papërcaktuar.
2. Dispozitat e këtij memorandumi nuk mund të ndryshohen, përmirësohen ose revokohen përveç se me pëlqimin me shkrim të të dyja palëve.
3. Ky memorandum mund të shfuqizohet me kërkesën e njërsë palë, pas njoftimit paraprak me shkrim, e cila parashtron edhe arsyet e prishjes së këtij memorandumi, të paktën 3 muaj përpara.

NENI 5 **NËNSHKRIMI DHE HYRJA NË FUQI**

Ky memorandum nënshkruhet në katër kopje origjinale me vlerë të njëjtë, dy për secilën palë dhe hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga të dyja palët.

**Për Fakultetin e Drejtësisë
Universiteti i Tiranës**




Prof. Dr. Dorina Hoxha

DEKAN



Për Agjencinë e Prokurimit Publik


Dr. Reida Kashta

DREJTOR I PËRGJITHSHËM